



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Prodato Received / Delivery	07-04-2023	3	viti god year
Organ / Njesia Org. / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	3442/2023		113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.423/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës A.nr.423/2023 të datës 27.02.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "kompensim material", në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 06.04.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

*Hedhet poshtë si e palejuar* ankesa me numër A.nr.423/2023 e datës 27.02.2023, e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 27.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2126/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për njohjen se së drejtës së kompensimit të shtesës për zyrtarë të teknologjisë informative, mbi bazën e Vendimit Nr. 02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në vlerë prej 200 Euro, dhe atë nga data e fillimit të punës me 15.05.2014.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ndërsa, Këshilli me datë 15.03.2023 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen ankimore.



*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 2126/2023 të datës 27.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për shtesë në pagë për IT me numër protokollit 267/23 e datës 23.01.2023 nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm të MMPHI; Kërkesën për shtesë në pagë për IT me numër protokollit 4161/2020 e datës 17.09.2020 parashtruar nga ankuesi te Sekretari i Përgjithshëm i MEA; Kërkesën për shtesë në pagë për IT me numër protokollit 6612/19 e datës 07.11.2019 parashtruar nga ankuesi të Sekretari i Përgjithshëm i MMPH; Vendimin me Nr. 02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Aneksi I; Vendimin me Nr. 03/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr. 81/2014 i datës 08.05.2014 për transferim të ankuesit; Akt Emërimit e datës 15.05.2014; Kërkesën për ndryshim plotësim të shtesave në paga e datës 15.10.2015 e parashtruar nga ankuesi tek Udhëheqësi i Divizionit të Personelit; Emailin e datës 25.01.2017 nga G.K për T.D; Kërkesën për përgjigje në ankesë më numër protokollit 2401/2023 e datës 06.03.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2697/2023 e datës 15.03.2023; Certifikatën me Nr. 02-79/II e datës 05.03.1990; Certifikatën me Nr. 28/13-MA-Em-10/35 e datës 21.06.2013; Certifikatën me Nr.53/10-07/55ME e datës 13.10.2010; Certifikatën me Nr. 02-298/I e datës 26.11.2008; Listën e pagave për ankuesin për vitin 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për TI dhe Shërbime Logjistike i datës 13.03.2014.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e palejuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe së i njëjti sipas Akt Emërimit të datës 15.05.2014 është emëruar dhe ushtron pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për TI dhe Shërbime Logjistike.*

Me tej nga provat e kësaj çështje rezulton se ankuesi më datë 23.01.2023 përmes kërkesës me numër protokollit 257/23 i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës më kërkesën për realizimin e shtesës të Menaxhimit të IT-së, sipas Vendimit me Nr. 02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërsa, ankuesi me datë 27.02.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar mbi të drejtën e kompensimit të shtesës mbi pagën bazë për zyrtar të teknologjisë informative sipas Vendimit me Nr. 02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në vlerën prej 200 Euro, dhe atë në mënyre retroaktive nga data 15.05.2014.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe 4 të të njëjtët ligj ku përcaktohet se: "1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes*






*administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ...” e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit e datës 27.02.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e para afatshme, pasi që ankuesit ende pa kaluar afati ligjor për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas kërkesës së datës 23.01.2023 të ushtruar të organi i punësimit, ka parashtruar ankesë në Këshill mbi bazën e njëjtë ligjore. Andaj, nisur nga ky fakt, rezulton se ankesa e ankuesit A.nr.423/2023 e datës 27.02.2023 është pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji.”*

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi lryn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.423/2023

Avdyll BEKTESHI

  
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MMPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.